



**RAPORT VJETOR  
PËR AKTIVITETIN AFARIST TË  
FONDIT PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE  
PËR VITIN 2022**

**Shkup, shkurt 2023**

## Përmbajtja

<b>REZIME</b> .....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
<b>I. LËVIZJA E DEPOZITAVE TË POPULLATËS NË SISTEMIN BANKAR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT GJATË VITIT 2022</b> .....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
<b>II. PORTOFOLI INVESTUES I FONDIT (01.01.2022 – 31.12.2022)</b> .....	<b>14</b>
<b>III. DËMSPËRBLIMI I DEPOZITUESËVE TË ANËTAREVE TË FONDIT TEK TË CILAT KA NDODHË RASTI I RREZIKUT (FALIMENTIM OSE LIKUIDIM)</b> .....	<b>16</b>
<b>IV. REZULTATET FINANCIARE PËR VITIN 2022</b> .....	<b>21</b>
<b>V. AKTIVITETE AFARISTE TË FONDIT GJATË VITIT 2022</b> .....	<b>24</b>
ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRUESE.....	24
PROCESE AFARISTE NË FONDIN PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE .....	27
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBETAR.....	29
MARDHËNIE ME PUBLIKUN.....	31
AKTIVITETE TË TJERA TË FONDIT PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE .....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

## REZIME

Viti i kaluar 2022 do të mbahet mend si një vit me shumë sfida globale, jo vetëm për ekonominë tonë në zhvillim, por edhe për Unionin Evropian dhe ekonomitë e tjera të zhvilluara. Të gjithë kemi qenë dëshmitarë të konfliktit ushtarak midis Ukrainës dhe Rusisë i cili filloi në mars të vitit 2022 dhe shkaktoi krizë të rëndë energjetike, e cila ndodhi pikërisht atëherë kur filloi procesi i shërimit nga pandemia botërore e COVID-19 me të cilën bota po lufton për plotë dy vite të vështira. Në fakt, ekonomitë nuk kishin hapsirë për t'u forcuar pas pandemisë, sepse u përballën me një valë të re problemesh, mungesë energjie, kufij të mbyllur, rritje të kostove të transportit dhe faktorë të tjerë të shumtë që shkaktuan një rritje të shpejtë inflacioni i cili preku të gjithë sektorët, ndër të cilët edhe sistemin financiar. Kriza energjetike, inflacioni i lartë, rritja e pasigurisë dhe ngadalësimi global i ekonomisë, si dhe shtrëngimi i kushteve të tregut financiar kontribuan në ngadalësim të mprehtë të aktivitetit ekonomik në vitin 2022.

Institucionet kompetente luftojnë fuqishëm me këta faktorë të jashtëm ndaj të cilëve ekonomia jonë nuk është immune dhe arrijnë të ruajnë stabilitetin financiar në nivele të larta. Këtë e dëshmon edhe Raporti i Agjencisë së Vlerësimit të Kredive “Standard and Poors”, i cili konfirmon vlerësimin e kreditit të vendit BB- me një perspektivë të qëndrueshme, ku thuhet se ndryshe nga vendet e tjera të rajonit, lidhjet e sektorit financiar të ekonomia e brendshme me Rusinë është e vogël, që do të thotë se nga kriza nuk ka efekte të drejtpërdrejta negative të transfertave në sistemin bankar vendas. Sa i përket sektorit bankar, Agjencia e thekson stabilitetin e tij, në kushtet kur kreditë jofuncionale janë ende të ulëta, në nivel të 3.2%, ndërkohë që norma e kapitalizimit të sektorit bankar është adekuate dhe e qëndrueshme dhe paraqet 17.7%<sup>1</sup>.

Treguesit makroekonomikë për sistemin ekonomik në Republikën e Maqedonisë së Veriut<sup>2</sup>:

1. Norma e rritjes së produktit të brendshëm bruto për vitin 2022 në Maqedoninë e Veriut është pozitive dhe arrin në 2,7%; 2. Norma vjetore e inflacionit tregon rritje të ndjeshme në vitin 2022 dhe arrin në 13.5%<sup>3</sup> (më e larta në tetor 2022 në masën 19.8%<sup>4</sup>); 3. shkalla e papunësisë në vitin 2022 është 14.5% (për vitin 2021 ishte 15.7% ndërsa shkalla e punësimin për vitin 2021 është 47.39% (për vitin 2021 ishte 47.2%); 4. paga mesatare mujore bruto e paguar për punonjës në nëntor 2022 ishte 49.397<sup>5</sup> denarë.

Gjatë vitit 2022 ka vazhduar pagesa e dëmshpërblimit për depozituesit e “Eurostandard Bank” SHA Shkup në falimentim, përmes katër bankave paguese. Deri më 31.12.2022, ishin të paguara 91,07% (3,8 miliardë denarë) nga dëmshpërblimi i përgjithshëm i llogaritur dhe atë, janë paguar 12.707 depozitues të “Eurostandard Bank” SHA Shkup në falimentim.

<sup>1</sup> Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

<sup>2</sup> Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut

<sup>3</sup> Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut

<sup>4</sup> Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

<sup>5</sup> Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Vërehet një rritje e depozitave të popullatës prej 5.97% për vitin 2022 (2021: 7.1%).

Më 31.12.2022, depozitat e përgjithshme të popullatës arritën në 336 miliardë denarë, prej të cilave 47,5% janë depozita në denarë, ndërsa 52,5% janë depozita në valutë të huaj. Mbledhja e premive në vitin 2022 u zhvillua me normën prej 0.25% në vit. Premitë llogariten në bazë të lëvizjes së depozitave totale të popullatës.

Gjendja e përgjithshme e portofolit të investimeve në fund të vitit 2022 ishte 17.280 milionë denarë sipas vlerës nominale (17.066 milionë denarë vlera aktuale). Në nivel vjetor shënon rritje prej 2,5 miliardë denarë, gjegjësisht rritje prej 17% në krahasim me gjendjen e portofolit të investimeve më 31.12.2021. Kjo rritje e portofolit investues të Fondit vjen si rezultat i pagimit të pjesëshëm të kërkesës së Fondit nga pasuria falimentuese e “Eurostandard Bank SHA Shkup në falimentim” në vlerë prej 1,5 miliard denarë, premi të paguara dhe interesit të riinvestuar nga bonove e reja në vitin 2022. . Gjatë vitit 2021, Fondi ka marrë pjesë në 15 ankande të bonove të thesarit nga Ministria e Financave.

Gjatë vitit 2022, Fondi mori pjesë në dy takime të Komitetit të Marrëdhënieve me Publikun në Forumin Evropian të Siguruesve të Depozitave (EFDI) nga gjithsej 3 që organizohen në nivel vjetor. Si anëtar aktiv i EFDI (Forumit Evropian të Siguruesve të Depozitave), Fondi mori pjesë edhe në Kuvendin e rregullt vjetor të EFDI, e cila u mbajt për herë të parë pas fillimit të pandemisë me prezencë fizike të delegatëve në ishullin e Rodosit në Greqi.

Fondi për Sigurimin e Depozitave mori pjesë në shënimin e Ditës Botërore të Kursimit përmes bashkëpunimit dhe organizimit me Shoqatën e Bankave të Maqedonisë, i cila u mbajt më 31.10.2021.

Drejtor  
Amir Shabani

## I. LËVIZJA E DEPOZITAVE BANKARE TË POPULLATËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT GJATË VITIT 2022


Vlera e përgjithshme e depozitave të popullatës në sektorin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të muajit dhjetor të vitit 2022 paraqiste 336 miliard denarë<sup>6</sup>. Lëvizjet mujore të depozitave të përgjithshme të popullatës në sektorin bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të treguara në Grafikon nr.1 ose të ndara në muaj në Tabelën nr.1. Rritja vjetore e depozitave paraqet 5,97%, nga të cilat peshë më të madhe ka rritja e depozitave prej 2,81% në muajin dhjetor të vitit 2022.

Rritja prej 5,97% në nivel vjetor është më i vogël se sa rritja e depozitave të popullatës e realizuar në vitin 2021 (7,1%) si pasojë e krizës së shkaktuar nga konflikti ushtarak ndërmjet Ukrainës dhe Rusisë, si dhe krizën e mëvonshme energjetike.

Sipas analizave është konstatuar se depozitat e afatizuara kanë rritje të vazhdueshme në vitin 2022 (9,56% krahasuar me vitin 2021), ndërsa depozitat e paafatizuara kanë shënuar rritje prej 2,53% në nivel vjetor krahasuar me të njëjtat në dhjetor të vitit 2021. E shprehur në përqindje depozitat e afatizuara në depozitat e përgjithshme të popullatës më 31.12.2022 marrin pjesë me 52,51% gjegjësisht depozitat e paafatizuara marrin pjesë me 47,49%.

Në aspekt të strukturës valutore, depozitat në denarë kanë rritje prej 2,25% ndërsa depozitat devizore rritje prej 9,56% krahasuar me dhjetorin e vitit 2021.

Grafiku 1. Lëvizjet mujore të depozitave të popullatës gjatë vitit 2022



<sup>6</sup> Depozitat e përgjithshme të popullatës paraqesin 5,45 miliard euro të përlogaritura sipas kursit të mesëm të BPRMV deri më 31.12.2022

Burimi: Të dhëna administrative të FSD

Tabela 1. Lëvizje mujore të depozitave të përgjithshme të popullatës në vitin 2022


(në një mijë denar)

Periudha	Projektme për lëvizjen e depozitave të përgjithshme të popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me Planin Financiar për vitin 2022	Projektme të rritjes mujore të depozitave të përgjithshme të popullatës në vitin 2022 (në përqindje)	Depozitat e përgjithshme të popullatës në RMV në vitin 2022	Rritje mujore në përqindje
31.12.2021	314.750.858		316.667.657	
31.1.2022	315.380.360	0,20	316.409.193	-0,08
28.2.2022	319.480.304	1,30	317.918.225	0,48
31.3.2022	320.279.005	0,25	312.414.161	-1,73
30.4.2022	320.919.563	0,20	315.003.771	0,83
31.5.2022	322.524.161	0,50	315.725.794	0,23
30.6.2022	323.394.976	0,27	319.113.293	1,07
31.7.2022	324.526.859	0,35	320.699.738	0,50
31.8.2022	327.447.600	0,90	321.756.069	0,33
30.9.2022	328.888.370	0,44	324.999.315	1,01
31.10.2022	329.875.035	0,30	325.961.533	0,30
30.11.2022	331.854.285	0,60	326.394.135	0,13
31.12.2022	336.832.099	1,50	335.558.907	2,81
<b>Rritje vjetore</b>		<b>7</b>		<b>5,97</b>

Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Gjatë mujait janar dhe shkurt të viti 2022, rritja mujore e depozitave të popullatës paraqite 0,48% . Në mars të vitit 2022, është shënuar rënie e theksuar e rritjes së depozitave (krahasuar me shkurtin e vitit 2022, rënie prej -1,73%) që daton prej fillimit të konfliktit ushtarak midis Ukrainës dhe Rusisë. Në të gjithë muajt e tjerë vërehet rritje e depozitave të popullatës, në prill të vitit 2022 u vu re një rritje prej 0,83% (mars 2022:prill 2022). Në maj 2022, rritja e depozitave është 0,23% (prill 2022: maj 2022), në qershor 1,07% (maj 2022: qershor 2022) dhe në korrik të 2022-it 0,5% (qershor 2022: korrik 2022). Në gusht 2022 ka rritje prej 0,33% (korrik 2022: gusht 2022). Pastaj në shtator 2022 ka rritje prej 1.01% (gusht 2022: shtator 2022), në tetor të 2022-it rritje prej 0.3% (shtator 2022: tetor 2022), nëntor 2022 rritje prej 0.13% (tetor 2022: nëntor 2022) dhjetor 2022 rritje prej 2.81% (nëntor 2022: dhjetor 2022).


Grafiku 2. Rritje e depozitave sipas muajëve gjatë vitit 2022



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Rritja vjetore e depozitave të përgjithshme të popullatës në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut në tre vitet e fundit është treguar në Grafikon nr.3

Grafiku 3. Rritje vjetore e depozitave 2020-2022




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Analiza e depozitave të popullatës në aspektin e strukturës valutore tregon se në janar të 2022 ka rënie në të depozitave në denarë prej(-1,63%), dhe rritje e vogël e depozitave devizore prej 1,44%. Në shkurt të viti 2022 shënohet rënie më e vogël e depozitave në denar prej (-0,05%) dhe rritje e vogël e depozitave devizore prej 0,97% , në mars të 2022 ka rënie në më të madhe të depozitave në denarë prej(-4,75) ndërsa rritje në depozitat devizore prej 1,08%, në prill të viti 2022 ka rritje në depozitat në denar 0,67% dhe rritje në ato devizore prej 0,97%, në maj të të vitit 2022 ulje të depozitave në denarë prej (-0,32%) dhe rritje deri në 0,70% në depozitat devizore,

në qershor të vitit 2022 rritje në depozitat në denarë prej 0,26% dhe rritje në depozitat devizore prej 1,78%, në korrik rritje prej 0,38% në depozitat në denarë, gjithashtu rritje prej 0,60% edhe në depozitat devizore, në gusht të viti 2022 rritje prej (-0,12) e depozitave në denarë dhe rritje e depozitave devizore prej 0,71%, në shtator të 2022-të ka rritje të depozitave në denarë 1,40% dhe rritje prej 0,68% në ato devizore, në tetor ka rritje në depozitat në denarë 0,26% dhe rritje prej 0,33% në ato devizore, në nëtor të 2022-të ka rritje në depozitat në denarë 0,45% dhe rënie prej 0,33% në ato devizore. Në dhjetor të viti 2022 ka rritje më të madhe prej 6,02% të depozitave në denarë gjithashtu rritje edhe në depozitat devizore pre prej 0,06%.

Grafiku 4. Lëvizja e depozitave në denarë dhe devizë në vitin 2022




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Depozita në denarë në depozitat në përgjithshme të popullatës deri më 31.12.2022 paraqesin 47,5%, për kundërt 52,5% pjesmarrëje të depozitave të përgjithshme devizore (Grafiku 5).




Grafikoni 5. Pjesëmarrje e depozitave të përgjithshme të popullatës në deviza dhe atyre në denar gjatë vitit 2022



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Sipas afatizimit, depozitat e paafatizuara kanë rritje prej 2,25% ndërsa ata të afatizuarat kanë rritje prej 9,56% krahasuar me vitin 2021. (Grafiku 6).


Grafiku 6. Lëvizja e depozitave të paafatizuara dhe afatizuara në vitin 2022 (në një mijë denarë)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Pjesëmarrje e depozitave të përgjithshme të popullatës të paafatizuara më 31.12.2022 paraqet 47,49%, ndërsa pjesëmarrja e depozitave të afatizuara në depozita e përgjithshme të popullatës deri më 31.12.2022 paraqet 52,51%. Në Grafikon nr.7 është paraqitur pjesëmarrja e depozitave të paafatizara dhe atyre të afatizuara të depozitave të përgjithshme të popullatës në tre vitet e fundit: 2020, 2021 dhe 2022.


Grafiku 7. Paraqitja e depozitave të paafatizuara dhe afatizuara në depozitat e përgjithshme të popullatës në vitin 2020, 2021 dhe 2022



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Niveli i dëmshpërblimit në pajtim me Ligjin e Fondit për Sigurimin e Depozitave është 30.000 euro në kundërvlerë me denarin për një depozitues në një bankë ose shtëpi kursimi. Në Shtojcën nr. 1 të këtij raporti janë treguar lëvizjet tremujore të depozitave të përgjithshme të popullatës të klasifikuara sipas pragut ligjor për dëmshpërblim në vlerë prej 1,85 milion denarë ose 30.000 euro në kundërvlerë me denarin. Analiza e depozitave të popullatës në pajtim me shumën e dëmshpërblimit tregon se pjesëmarrja e **depozitave të siguruara** të popullatës në depozitat e përgjithshme është më e madhe në tremujorin e fundit të vitit 2022 dhe atë 72,19% , ndërsa më e ulët në tremujorin e parë të vitit 2022 me vlerë prej 70,86%. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës **deri në 30.000 euro** në depozitat e përgjithshme është më e madhe në tremujorin e katërt të vitit 2022 me 53,42% ndërsa më e ulët në tremujorin e parë të 2022-it me 52,76%. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës në vlerë **mbi 30.000 euro** në depozitat e përgjithshme është më e lartë në tremujorin e parë të vitit 2022 me 47,23% , ndërsa më e ulët në tremujorin e katërt të vitit 2022 me vlerë prej 46,57%. (Grafiku 8)


Grafiku 8. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin në **depozitat e përgjithshme** të popullatës (IVQ.2021 – IVQ.2022)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Depozitat e popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin analizohen veç e veç sipas bankave dhe shtëpitë e kursimit, dhe duke u nisur prej këtu depozitat e popullatës **deri në 30.000 euro** nëpër banka, në depozitat e popullatës është më e madhe në tremujorin e katërt të vitit 2022 me 53,21% ndërsa më e ulët në tremujorin e katërt të vitit 2022 në vlerë prej 53,21%. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës **mbi 30.000euro në kundërvlerë me denarin në një bankë**, në depozitat e përgjithshme të popullatës është më e lartë në tremujorin e parë të vitit 2022 dhe atë me 47,23%, ndërsa më e ulët në tremujorin e katërt të viti 2022 me 46,57% (Grafiku 9).


Grafiku 9. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin në banka, depozitat e përgjithshme të popullatës në banka -anëtare të FSD-së (IVQ.2021 – IVQ.2022 )



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Pjesëmarrja e depozitave të popullatës **deri në 30.000 euro në shtëpi të kursimit** në depozitat e përgjithshme të popullatës në shtëpitë e kursimit është më e madhe në tremujorin e dytë të vitit 2022 me 76,33%, ndërsa më e ulët në tremujorin e tretë të vitit 2022 me 73,10%. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës **mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin në shtëpitë e kursimit** në depozitat e përgjithshme të popullsisë në kursimore është më e lartë në tremujorin e tretë të vitit 2022 dhe paraqet 26,90%, ndërsa më e ulët në tremujorin e dytë të 2022 me 23,67% (Grafiku 10).

Grafikoni 10. . Pjesëmarrja e depozitave të popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin **në shtëpi të kursimit** në depozitat e përgjithshme të popullsisë në kursimore -anëtare të FSD (IVQ.2021 – IVQ.2022 )




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Pagesa e premive në vitin 2022 zhvilloheshte sipas procedurave të rregullta, me normë të përcaktuar prej 0,25% në nivel vjetor.

Mjetete e përgjithshme të cilat i'u paguan Fondit në vitin 2022 në bazë të premisë paraqesin 799 milion denarë ose 12,9 milion euro (Grafiku 11).


Grafiku 11. Lëvizja e shumës mujore të premive në vitin 2022



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Norma e mbulimit të depozitave të popullatës( mjetet e përgjithshme të Fondit në lidhje me depozitat e përgjithshme të popullatës) në dhjetor të vitit 2022 paraqet 5,23% dhe është mbi minimumin ligjor prej 4%. Gjatë viti 2022 norma e mbulimit është më e lartë në shtator të viti 2022 me 5,35%, që ka të bëjë me pagimin e 34% të kërkesës së Fondit për Sigurimin e Depozitave që e kishte ndaj Eurostandard bankë SHA Shkup në falimentim, ndërsa më e vogël në shkurt të 2022-të me 4,83% (Grafiku 12).

Grafikoni 12. Lëvizja e normës së mbulimit në vitin 2022




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

## I. PORTOFOLI INVESTUES I FONDIT (01.01.2022– 31.12.2022)

Gjendja e përgjithshme e portofolit investues në fund të viti 2022 paraqiste 17.280 milion denarë sipas vlerës së tyre nominale (17.066 milion denarë vlera e tanishme). Në nivel vjetor shënon rritje prej 2,5 milion denarësh gjegjësisht rritje prej 17% krahasuar me gjendjen e portofolit investues më 31.12.2021. Kjo rritje e portofolit investues të Fondit ka të bëjë me pagesën e pjeshëme të kërkesës së Fondit nga pasuria falimentuese e „Eurostandard bankë SHA Shkup në falimentim,“ në vlerë prej 1,5 miliardë denarë, premisë së paguar dhe reinvestimit të kamatës nga bonot e reja në vitin 2022. Në raport me gjendjen e planifikuar të plasmanit në bono thesari në fund të vitit 2022 (15,620 milionë denarë, vlera nominale), indeksi i bonove të planifikuara në raport me bonot e investuara është 110,6%, që tregon për rritje të investimit të mjeteve të Fondit në raport me atë të planifikuarën. (Grafiku 13).

Grafiku 13. Portofoli investues i Fondit në bono të thesarit shtetëror për vitin 2022




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Fondi morri pjesë në gjithsej 15 aukcione të bonove të thesarit të Ministrisë së Financave, në pajtim me politikën investuese të Fondit për Sigurimin e Depozitave shuma e përgjithshme e portofolit investues të Fondit nuk kaloi 99,00% nga totali i gjendjes së mjeteve të përgjithshme dhe gjendjes së letrave me vlerë të Fondit në fund të çdo muaji, ndërsa më 31.12.2022 ky raport paraqite 97,4%.

Portofoli investues i Fondit në fund të vitit është i përbër nga bono thesari me afat maturimi prej 364 ditësh. Në mënyrë shtesë , në këtë periudhë kishte edhe ndryshim të normave të interesit gjegjësisht normë interesi të bonove me afat maturimi deri në 364 ditë të cilatë lëviznin prej 0,6% në janar të viti 2022, në 3,5% në dhjetor të 2022-shit.

Grafiku 14. Normat e interesit për bonot 12 mujore shtetërore në vitin 2022



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Të ardhurat e përgjithshme të Fondit në bazë të interesit në vitin 2022 nga bonot me afat të paarritur nga viti 2021 dhe interesat e bonove të reja të afatit të arritur në vitin 2022 paraqite 124,7 mijë denarë. Në raport me interesin e planifikuar për vitin 2022, Fondi ka marrë 61% më shumë të ardhura nga plasmanet se sa që ishte planifikuar. Ky tejkalim i të ardhurave të planifikuara nga plasmanet në raport me ato të realizuara vjen si pasojë e rritjes së aktivitetit investues dhe rritjes së normës së interesit, e cila gjatë periudhës së përgatitjes së planeve për politikën e investimeve për vitin 2022 është supozuar të jetë 0.5 % për ankand, por megjithatë ato vazhduan të rriteshin gjatë vitit 2022 nga 0.6% (janar 2022) në 3.5% (dhjetor 2022).

Shpenzimet për provizion për bankat ndërmjetsuese të aukcioneve paraqet 525 mijë denar.

Tabela 2. Pasqyrë e dinamikës së bonove të thesarit shtetëror të planifikuara, të reja dhe normat e interesit për të njejtat për periudhën prej 01.01.2022 deri 31.12.2022  
(në denarë)



RAPORTI VJETOR PËR AKTIVITETIN AFARIST TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2022

2022/muaj	Bonot e reja shtetërore (BSH) në periudhën janar-dhjetor 2022 (në shumën nominale)			Bono thesari të planifikuara (BSH) në periudhën janar-dhjetor 2022 (në shumën nominale)			Diferenca në shumën nominale 4-6	Indeksi 4/6	Interesi për bonot e reja të thesarit			Komisioni (provizion)
	data e pageses	data e maturimit	BSH të reja	data e maturimit	BSH të maturuara	BSH të planikuara			Norma e interesit (%)	interesi deri në maturim	norma deri më 31.12.2022	
1	2	3	4		5	6	7	8	9	10	11	
janar			660.000.000		600.000.000	660.000.000	0	100,0%		3.828.000	3.707.688	35.000
	26.01.2022	11.01.2023	660.000.000	26.01.2022	600.000.000	660.000.000			0,60	3.828.000	3.707.688	35.000
shkurt	09.02.2022	08.02.2023	830.000.000	09.02.2022	760.000.000	830.000.000	0	100,00%	0,60	5.004.900	4.468.659	35.000
mars			3.790.000.000		3.690.000.000	3.760.000.000	30.000.000	100,80%		26.636.120	21.883.341	70.000
	02.03.2022	01.03.2023	3.120.000.000	02.03.2022	3.040.000.000	3.110.000.000	10.000.000	100,32%	0,70	21.927.360	18.312.960	35.000
	30.03.2022	29.03.2023	670.000.000	30.03.2022	650.000.000	650.000.000	20.000.000	103,08%	0,70	4.708.760	3.570.381	35.000
prill			1.300.000.000		1.230.000.000	1.300.000.000	0	100,00%		9.136.400	6.576.200	35.000
	13.04.2022	12.04.2023	1.300.000.000	13.04.2022	1.230.000.000	1.300.000.000	0	100,00%	0,70	9.136.400	6.576.200	35.000
maj			1.100.000.000		1.040.000.000	1.110.000.000	-10.000.000	99,10%		8.826.400	5.674.116	35.000
	11.05.2022	10.05.2023	1.100.000.000	11.05.2022	1.040.000.000	1.110.000.000			0,80	8.826.400	5.674.116	35.000
qershor	15.06.2022	14.06.2023	600.000.000	15.06.2022	520.000.000	590.000.000	10.000.000	101,69%	1,40	8.374.800	4.578.529	35.000
korrik	13.07.2022	12.07.2023	120.000.000	13.07.2022	60.000.000	130.000.000	-10.000.000		1,50	1.792.800	842.223	35.000
gusht	03.08.2022	02.08.2023	450.000.000	03.08.2022	380.000.000	450.000.000	0	100,00%	2,00	8.919.450	3.675.598	35.000
shtator	07.09.2022	06.09.2023	1.550.000.000			60.000.000	1.490.000.000	2583,33%	2,00	30.722.550	9.706.300	35.000
tetor			2.410.000.000		2.280.000.000	2.360.000.000	50.000.000	102,12%		59.363.990	11.480.576	70.000
	12.10.2022	13.10.2023	820.000.000	12.10.2022	720.000.000	800.000.000	20.000.000	102,50%	2,30	18.636.140	4.095.856	35.000
	26.10.2022	25.10.2023	1.590.000.000	26.10.2022	1.560.000.000	1.560.000.000	30.000.000	101,92%	2,60	40.727.850	7.384.720	35.000
nëntor			3.340.000.000		3.180.000.000	3.260.000.000	80.000.000	102,45%		98.114.740	10.875.930	70.000
	16.11.2022	15.11.2023	2.300.000.000	16.11.2022	2.170.000.000	2.250.000.000	50.000.000	102,22%	2,90	65.520.100	8.100.013	35.000
	30.11.2022	29.11.2023	1.040.000.000	30.11.2022	1.010.000.000	1.010.000.000	30.000.000	102,97%	3,20	32.594.640	2.775.917	35.000
dhjetor												
	14.12.2022	13.12.2023	1.130.000.000	14.12.2022	1.030.000.000	1.110.000.000	20.000.000	101,80%	3,50	38.622.270	1.803.787	35.000
Gjithsej:			17.280.000.000		14.770.000.000	15.620.000.000	1.660.000.000			299.342.420	85.272.947	525.000

Burimi:Të dhëna administrative të FSD-së

## I. DËMSPËRBLIMI I DEPOZITUESVE TË ANËTAREVE TË FONDIT TEK TË CILËT KA NDODHUR RAST I RREZIKUT (FALIMENTIM OSE LIKUIDIM)

Dëmshpërblimi i depozituesve të anëtarëve të Fondit tek të cilët ka ndodhur rast i rrezikut (falimentim ose likuidim) është një nga tre aktivitetet themelore afariste të Fondit.

Që nga themelimi i Fondit në janar të viti 1997 deri më 31.12.2022 kanë ndodhur gjithsej 12 raste me rrezik dhe atë në 5 banka dhe 7 shtëpi kursimi. Përlllogaritja e përgjithshme për kompensim nga dymbëdhjetë ish anëtarët e Fondit është 5,7 miliardë denarë. Nga viti 1997 deri më 31.12.2022 janë dëmshpërblyer gjithsej 32,790 depozitues në vlerë të përgjithshme prej 5,18 miliardë denarë, që paraqet 90,82% të detyrimeve të paguara nga FSD-së për dëmshpërblim ndaj depozituesve. Pjesa tjetër prej 9,18% paraqet obligim për dëmshpërblim në vlerë të përgjithshme prej 0,52 miliardë denarë (Tabela 1).

Rasti i fundit i rrezikut ndodhi më 12.08.2020 kur ndaloj të punojë „Eurostandard bankë,, SHA Shkup.

Gjatë vitit 2022 vazhdoi pagesa e dëmshpërblimeve të depozitorëve të “Eurostandard Bankës” SHA Shkup në falimentim nëpërmjet katër bankave paguese: Komercialna Bankë SHA Shkup, Stopanska Bankë SHA Shkup, NLB Bankë SHA Shkup dhe Halk Bankë SHA Shkup.

Analiza e shumave të paguara të dëmshpërblimit të “Eurostandard Bankës” SHA Shkup në falimentim, sipas shumës së depozitave tregon se përqindja më e madhe prej **98,93%** e depozitave të paguara i takojnë depozitave në vlerë prej 1.200.001-1.850.889 denarë (≈20.000 deri në 30.000 euro), d.m.th. deri në pragun maksimal të dëmshpërblimit, **95,47%** për depozitat në vlerë prej 600,001-1,200,000 (≈10,000 deri në 20,000 euro), **91,27%** për depozitat në vlerë prej 300,001-600,000 deri ( 5,000 deri në 10,000 euro), **83,47%** depozita në vlerë prej 100.001-300.000 denarë (≈1.500 deri në 5.000 euro), **73,79%** të depozitave në vlerë prej 60.001-100.000 denarë (≈1.000 deri 1.500 euro), **64,75%** të depozitave në vlerë prej 30.001-60.000 denar (≈500 deri 1.000 euro), **48,44%** të depozitave në vlerë prej 20.001-30.000 denarë (≈320 deri në 500 euro), **36,90%** të depozitave në vlerë prej 10.001 - 20.000 denarë (≈160 deri në320euro)**18,55%** depozita në vlerë prej 5.001-10.000 denarë (≈80 deri në 160 euro), **8,44%** depozita në vlerë prej 1.001-5.000 denarë (≈16 deri në 80 euro), **2,24%**, depozita në vlerë prej 501-1.000 denarë( 8 deri në 16 euro), **1,04%** e depozitave në vlerë prej 101-500 denarë (≈1,5 deri në 8 euro) dhe **0,25%** e depozitave në vlerë prej 1 - 100 denarë (≈0,1 deri në 1,5 euro).

Sa më të vogla të jenë shumat e depozitave, aq më e ulët është përqindja e depozitave të paguara në kategorinë përkatëse. Pagesa më e ulët është në kategoritë deri në 20.000 denarë. Gjegjësisht, **69.501 depozitues të papaguar** i përkasin kategorisë 1 - 100 denarë ( $\approx 0.1$  deri në 1.5 euro), **20.628** depozitues të papaguar në kategorinë 101-500 denarë, **8.104** depozitues të papaguar në kategorinë 501-1.000 denar, **15.121** depozitues të papaguar nga kategoria 1.001-5.000 denarë, **5.477** depozitues të papaguar nga kategoria 5.001-10.000 denarë dhe **2.794** depozitues të papaguar në kategorinë 10.001-20.000 denarë.

Në tabelën nr.2 Pasqyrë e dëmshpërblimeve të përlogaritura të deponentëve të paguara dhe papaguara të „Eurostandard bankë,, SHA Shkup në falimentim në periudhën prej 15.09.2020 deri më 31.12.2022, është dhënë pasqyrë tabelare e pagesës e ndarë në kategori me shumë dëmshpërblimi.

Ashtu si edhe më parë, përvoja tregon se depozituesit nuk janë të interesuar të realizojnë të drejtën e tyre për dëmshpërblim nëse bëhet fjalë për vlera jotërheqëse të dëmshpërblimit.

Përveç pagesës së dëmshpërblimit përmes katër bankave pagueuse, Fondi punon edhe për pagesën në bazë të trashëgimisë nga depozitor të „Eurostandard bankës,, SHA Shkup në falimentim, të cilët kanë ndërrur jetë.

Drejtori i Fondit edhe më tej vazhdon të bëjë përpjekje për shlyerjen e kërkesës së FSD-së nga pasuria falimentuese e Eurostandard bankë SHA Shkup në falimentim, duke theksuar rëndësinë e zgjidhjes së shpejtë dhe efikase të kreditorëve në procedurën e falimentimit, në mbledhjet e Këshillit të kreditorëve dhe Kuvendin e kreditorëve të ESB-së në falimentim. Në planin për shpërndarjen e parë paradhënie kreditorëve të Eurostandard bankë SHA Shkup në falimentim me shumë të konstatuar prej 3.100.000.000,00 denarë me përqindje të shlyerjes prej 46,80% të FSD-së, e cila është përgatitur sipas procesverbalit të mbledhjes së 13-të të Këshillit të kreditorëve, në të cilin anëtarët e Këshillit të kreditorëve votuan me 3 vota “PËR “ ” dhe 2 vota “KUNDËR” u mor Vendim të që të hartojë plan shpërndarjeje paraprake, i cili do të përcaktojë kreditorët (persona juridikë dhe fizikë) me pagesë të rendit të dytë të skemës - tabela e kërkesave të përcaktuara dhe të kontestuara, të shlyhen para Fondit të Sigurimit të Depozitave.

